



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Ekonomisë - Ministarstvo Ekonomije - Ministry of Economy



THE RENEWABLE  
ENERGY SOURCE  
IN KOSOVO

# Ankandi solar 100 MW në Kosovë

## Mundësi për të investuar në një të ardhme të ndritshme energjetike

Kosova ka prioritetizuar modernizimin dhe përmirësimin e kapacitetit të saj prodhues në sektorin e energjisë përmes investimit dhe zhvillimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë në vend. Ministria e Ekonomisë do të organizojë ankandin e parë solar në muajt në vijim. Ky parashihet të jetë ankandi i parë që i hap rrugë shumë ankandëve të tjera për energji të ripërtëritshme.

Bëhuni pjesë e rrugëtimit tonë drejt energjisë së ripërtëritshme.

## PËRFITIMET NGA ANKANDI

Qeveria e Kosovës, duke zgjedhur që të mbajë ankande në mënyrë strategjike, po përpiqet të lehtësojë rrethanat për çmime konkurruese të energjisë së ripërtëritshme, zvogëlim të kostove, lehtësim të qasjes në energji të qëndrueshme dhe me çmime të përballeshme dhe rritje të transparencës në procesin e prokurimit të energjisë. Ankandi është një proces konkurrues përmes së cilit politikëbërësit blejnë energji elektrike që gjenerohet prej burimeve të ripërtëritshme të energjisë.

I organizuar përmes një procesi të hapur dhe transparent, ankandi solar i Kosovës do t'u ofrojë investitorëve një numër avantazhesh të rëndësishme, përfshirë këtu sigurimin e çmimit të garantuar, procedurat administrative të harmonizuara me agjencitë qeveritare dhe pa kosto për sigurimin e tokës.

*\*Kontrata e Ankandit jepet në bazë të çmimit më të ulët të garantuar të blerjes.*

# PËRPARËSITË E LOKACIONIT

Duke punuar ngusht me ekspertët vendorë dhe ndërkombëtarë, Ministria e Ekonomisë ka përzgjedhur një lokacion ideal për ankandin e parë solar në Kramovik, Komuna e Rahovecit, për zhvillimin e një centrali me energji solare prej 100 MW.

LOKACIONI ËSHTË NË TOKË PUBLIKE DHE KA KËTO VEÇORI:

- **TERREN I FAVORSHËM PËR NDËRTIM DHE INSTALIM;**
- **QASJE E LEHTË PËR AUTOMJETE DHE PAJISJE**
- **RREZATIM I LARTË SOLAR, ME ORIENTIM JUGOR DHE JUGPERËNDIMOR;**
- **QIRADHËNIE 30 VJEÇARE;**
- **MARRËVESHJE E GARANTUAR 15 VJEÇARE PËR BLERJEN E ENERGJISË; DHE**
- **KYÇJE E AFËRT NË RRJET.**




## RILEVIMI SOLAR I KRAMOVIKUT

Një rilevim i detajuar i lokacionit të Kramovikut, me anë të teknologjisë së dronit, është realizuar në fund të 2022 me mbështetjen e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Rilevimi ka kapur imazhe ajrore të përditësuara dhe ka krijuar modele digjitale të sipërfaqes.

Analiza e modelimit diellor dhe ekspozimit diellor ka treguar një lokacion të mirë-pozicionuar për një central të madh solar, me potencial të supozuar prej 117 MW në pik. Të dhënat e rilevimit dhe topografia digjitale do të jenë në dispozicion.

Legjenda

Analiza e pjerrësisë së Kramovikut




KRAMOVIK - PARKU SOLAR DHE PARCELAT

# PSE TË INVESTOHET NË ENERGJI TË RIPËRTËRITSHME NË KOSOVË?

Mjedisi biznesor në Republikën e Kosovës po bëhet një nga mjediset më konkurruese në rajon. Procesi i shpejtë dhe i lehtë i regjistrimit të biznesit, qeverisja e favorshme tatimore, sistemi i shkëlqyeshëm ligjor dhe ligjet transparente për investime të huaja janë vetëm disa prej përparësive që e bëjnë Kosovën destinacion atraktiv dhe miqësor për investitorët e energjisë të ripërtëritshme, ndërkombëtarë dhe vendorë.

Kosova ka pozitë të mirë gjeostrategjike, ekonomi me kosto konkurruese dhe norma të ulta tatimore, fuqi punëtore të re, shumë mundësi energjetike të paeksploruara dhe përkushtimin për t'u integruar në tregun global.



Banka Botërore, Burimi: "Global Solar Atlas 2.0", të dhënat për burimet solare

## POTENCIALI PËR ENERGJI SOLARE: KOSOVË

## SYNIMET AMBICIOZE TË KOSOVËS

Deri në vitin 2031, Qeveria e Kosovës synon të arrijë 35% të gjenerimit nga energjia e ripërtëritshme dhe deri në vitin 2050, neutralitetin e karbonit. Një element i rëndësishëm i kësaj strategjie është zbatimi i mundësive të bazuara në treg, në formën e ankandeve konkurruese, për të krijuar kapacitete të reja të energjisë së ripërtëritshme me çmime të përballueshme.

# PRIORITIZIMI I REFORMËS DHE INVESTIMEVE

Qeveria e Kosovës së fundi ka ndërmarrë reforma të rëndësishme në sektorin e energjisë me synim liberalizimin dhe zhvillimin e tregut të energjisë elektrike. Përmes **Strategjisë së Energjisë 2022-2031** dhe Ligjit në proces të **Burimeve të Ripërtërithme të Energjisë**, Kosova ka prioritetizuar dhe lehtësuar investimin në një numër të madh iniciativash për energji të ripërtërithme.

Për më tepër, vendi është anëtar i plotë i **Traktatit të Komunitetit të Energjisë i Evropës Juglindore** (Bashkimi Evropian) dhe është përkushtuar për zbatimin e caqeve ambicioze për energji të ripërtërithme dhe dekarbonizim të **Acquis Communautaire për Energjinë, Konkurrencën, Energjinë e Ripërtërithme dhe mjedisin.**

## CAQET PËR ENERGJI TË RIPËRTËRITSHME DERI 2031



**1.2 GW**

Të zhvillohen kapacitete të reja për erë dhe FV



**35%**

Pjesa e energjisë së ripërtërithme



**100 MW**

Të gjeneruara nga prosumatorët e rinj



**170 MW**

Ruajtja e baterisë

## PËR MË SHUMË INFORMATA

Ministria e Ekonomisë do të mbajë ankandin e parë solar në muajt në vijim. Për më shumë informata për procesin e tenderimit të ankandit solar, vizitoni <https://reskosovo.rks-gov.net/>

### NA KONTAKTONI

Sheshi "Zahir Pajaziti"  
10000 Prishtinë

Tel:+381 38/200 215 17  
[reskosovo@rks-gov.net](mailto:reskosovo@rks-gov.net)  
<https://me.rks-gov.net>



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Ekonomisë - Ministarstvo Ekonomije - Ministry of Economy